



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 145 dt.10.06.1994

PER
KALIMIN KAPITAL TE NJE FURRE BUKE

Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës, i mbledhur më dt.10.06.1994, pasi shqyrtoi relacionin e Seksionit të Tregtisë dhe Industrisë Ushqimore “Mbi kalimin kapital të një furre buke”,

VENDOSI

1. Makineritë dhe pajisjet e linjës së bukës të ngritur nga Ndërmarrja e Prodhimit të Suprave dhe Ndërmarrja e Prodhimit të Konservave të Mishit, të bëhet kalim Kapital në Ndërmarrjen e Prodhimit të Suprave me vlerë 608.238 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Seksioni i Tregtisë dhe Industrisë Ushqimore si dhe dy ndërmarrjet e mësipërme.

KRYETARI

BESNIK PETRELA